

Organizata Jo-qeveritare Education for Development and Cultural Outreach
Edukimi për Zhvillim dhe Shtrirje Kulturore
EDUCO



STRATEGJIA E ORGANIZATËS PËR PERIUDHËN 2024-2028

Rr. Zahir Pajaziti nr.100, 20000, Prizren, Kosovë
ojq.educo@gmail.com / www.ojqeducu.org / +38349586202

Përmbajtja

1. Hyrja	3
2. Qëllimi	3
3. Misioni	4
4. Vizioni	5
5. Metodologjia e punës	5
6. Fushëveprimet	11
6.1 Edukim/Trajnim	11
6.2 Përfshirje Sociale	11
6.3 Trashëgimi Kulturor	12
6.4 Kulturë	13
6.5 Rini	13
7. Programet	14
7.1 Konferenca e Turizmit dhe Mikpritjes në Prizren - KonTur	14
7.2 Edukim dhe Trajnim	15
7.3 Media	18
7.4 Trashëgimia Kulturor	21
7.5 Erasmus +	24
8. Shënimi i ditëve Ndërkombëtare	25

1. Hyrja

EDUCO është një organizatë jofitimprurëse që mbështet të rinjtë në aftësimin e tyre duke ofruar programe edukimi dhe trajnimi në përmbledhje të fushave të ndryshme që organizata mbulon. Qëllimet tona janë të ndihmojmë të rinjtë të ndërtojnë një të ardhme të ndritshme duke zhvilluar aftësitë e tyre dhe duke i bërë ata të aftë për të kontribuar në komunitetin e tyre.

Për të arritur këto qëllime, planifikohet dhe zbatohen fushëveprimet të cilat përfshijnë Edukim/Trajnim, Përfshirje Sociale, Trashëgimi Kulturor, Kulturë dhe Rini. Gjatë këtij plani të punës, do të paraqiten më shumë qëllimet dhe mënyrat se si po punohet për t'i arritur ato.

E gjithë puna jonë bazohet në Qëllimet e Zhvillimit të Qendrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG).

2. Qëllimi

Qëllimi i Edukimit për Zhvillim dhe Shtirje Kulturor - EDUCO është të promovojë akses në arsim cilësor dhe mundësi shkëmbimi kulturor në komunitetet në mbarë vendin. Ne besojmë se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe një mjet i fuqishëm për zhvillimin personal dhe shoqëror. Nëpërmjet programeve tona, ne përpiqemi të fuqizojmë individët dhe komunitetet për të arritur potencialin e tyre të plotë dhe për të dhënë kontribute pozitive për shoqëritë e tyre.

Qëllimi i fokusuar në edukimin për zhvillim është:

- Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive në aktivitete të shoqërisë, ndihma e nevojshme për të ndërgjegjësuar për sfidat globale si ndryshimet klimatike dhe të drejtat e njeriut.
- Zhvillimin e aftësive të ndryshme profesionale, personale si dhe ndërpersonale;
- Përmirësimi i përfshirjes dhe mbështetjes së grupeve të diversifikuara të të rinjëve, duke përfshirë ata nga komunitetet e dobëta socio-ekonomike, minoritetet etnike dhe të rinjtë me nevoja të veçanta.
- Zhvillimi i aftësive të të rinjëve për të punuar dhe për të bashkëvepruar në një mjedis multikulturor, duke përfshirë sensibilitetin për diversitetin kulturor, gjuhësor dhe religjioz dhe aftësinë për të komunikuar dhe për të punuar me individë të kulturave të ndryshme.

- Inkurajimi i vazhdueshmërisë së mësimi dhe zhvillimit personal dhe profesional në të gjithë jetën e të rinjëve, duke promovuar kulturën e qëndrueshmërisë dhe mbështetjen e trajnimeve dhe programeve të vazhdueshme të arsimimit.
- Trajnimi i të rinjëve për të menaxhuar efikasitetin e kohës dhe stresin, duke inkurajuar një qasje të balancuar ndaj punës dhe jetës personale.

Qëllimi i fokusuar në shtrirjen kulturore është:

- Promovimi i shkëmbimit kulturor dhe mirëkuptimit midis komuniteteve dhe vendeve të ndryshme.
- Ruajtja dhe festimi i traditave dhe trashëgimia kulturore e komuniteteve të ndryshme.
- Edukimi i publikut për kulturat e ndryshme dhe kontributin e tyre në vend.
- Avokimi për të drejtat dhe nevojat e të gjitha grupeve kulturore pa dalluar edhe grupet e marginalizuara ose të nënpërfaqësuar.
- Mbështetja e zhvillimit të programeve dhe iniciativave kulturore në komunitetet anëmbanë vendit.
- Fasilitasi i shkëmbimit kulturor për individët, siç janë programet e studimit jashtë vendit ose programet vullnetare.
- Bashkëpunimi me organizata të tjera për të promovuar ndërgjegjësimin dhe mirëkuptimin kulturor.
- Sigurimi i burimeve dhe mbështetje për të ndihmuar grupet kulturore të ruajnë dhe ndajnë traditat dhe trashëgiminë e tyre.
- Inkurajimi i dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë midis njerëzve të kulturave të ndryshme.
- Puna për eliminimin e diskriminimit dhe promovimin e përfshirjes dhe diversitetit brenda komuniteteve dhe shoqërive.

3. Misioni

Misioni i organizatës do të përfshijë lëvizjen për ndryshim të qëndrueshëm duke ofruar programe që mbështesin ndryshimin e gjithëpërfshirës në fusha të ndryshme si për shembull edukimi, shoqëria dhe kultura.

4. Vizioni

Vizioni ynë është një botë ku çdo person ka mundësinë të marrë një arsimim që i mundëson atij/asaj të arrijë potencialin e plotë dhe të japë kontribute domethënëse për komunitetet e tyre. Ne parashikojmë një botë ku shkëmbimi dhe mirëkuptimi kulturor promovohen si një mjet për të nxitur unitetin dhe bashkëpunimin. Ne besojmë se duke punuar së bashku, mund të krijojmë një të ardhme më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë.

5. Metodologjia e punës

Sipas metodologjisë së punës, organizata zbaton projektet dhe aktivitetet e saj për të arritur qëllimet me sukses. Ajo përfshin hapat që organizata ndërmerr për të planifikuar, zbatuar dhe mbikëqyrur projektet dhe aktivitetet e saj.

Metodologjia e punës do të ndryshojë në varësi të qëllimeve të organizatës, burimeve të disponueshme dhe kontekstit në të cilin organizata operon.

EDUCO në vazhdimësi mundohet që të jetë miku i natyrës, në këtë rast, duke përdorur materiale recikluese dhe të ripërdorshme, kursim në energji elektrike, përdorimi i enëve të ripërdorshme, pra nuk përdorim plastikë dhe hapësirat e EDUCO janë të ndërtuara me materiale jo të dëmshme për natyrën.

Megjithatë, elementet e poshtëshënuara do të përfshihen në metodologjinë e punës:

- **Identifikimi i qëllimeve:** Organizata vazhdimisht do të identifikojë qëllimet e qarta dhe do të vendosë një plan për t'i arritur ato qëllime.
- **Identifikimi i burimeve:** Organizata do të identifikojë burimet e nevojshme për të arritur qëllimet e saj, si për shembull financat, njerëzit, teknologjinë, etj.
- **Planifikimi:** Organizata do të bëjë plane të detajuara për të arritur qëllimet e saj duke përdorur burimet e disponueshme.
- **Zbatimi:** Organizata do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të implementuar planin e saj, duke siguruar që projektet dhe aktivitetet e saj të realizohen me sukses.
- **Mbikëqyrja dhe vlerësimi:** Organizata do të mbikëqyrë progresin dhe do të bëjë ndryshime në plan nëse është e nevojshme për t'i arritur qëllimet e saj. Ajo gjithashtu do të

vlerësojë rezultatet e projekteve dhe aktivitetëve të saj për të siguruar që ato janë efektive dhe që po ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të organizatës.

Përveç këtyre elementeve, për të pasur rezultate sa më të kënaqshme dhe plotësim të qëllimeve të organizatës gjithashtu do të përdoren instrumente të ndryshme, në ambiente të ndryshme për të pasur impakt sa më pozitiv në shoqëri përmes projekteve dhe aktivitetëve. Metodatat apo instrumentet që do të përdoren vazhdimisht janë:

- **Punë me vullnetarë:** Për të arritur ndryshime pozitive në shoqëri angazhohen vullnetarët për procese të caktuara, ku ata ofrojnë kohën, aftësitë dhe energjinë e tyre për të kontribuar në misionin dhe qëllimet e organizatës, një ndër ta është edhe angazhimi i tyre në hartimin e kësaj strategjie.
- **Puna në zyre:** Zyra ofron platformën për planifikim, koordinim, dhe monitorim të projekteve, duke përfshirë menaxhimin e burimeve financiare dhe njerëzore. Këtu ekipi administrativ dhe profesional do të zhvillojnë strategjitë e tyre, bashkëpunojnë me partnerët dhe donatorët dhe hartojnë raporte për të mbajtur të përditësuar të gjithë palët e interesuara. Fillet e të gjitha proceseve, e bëjnë hapin e parë në ambientet e zyrës prej 85m² të ndarë në ambientet EDUCO Takim, EDUCO Zyre, EDUCO Hapësira dhe EDUCO Podcast. Pra, analizimi i nevojave dhe i parimeve, duke identifikuar qëllimet dhe nevojat e ekipit punues në mënyrë që të përmbushen qëllimet bëhet në këto hapësira.
 - Në EDUCO Zyre mund të ambintohen 4 persona
 - Në EDUCO Takim mund të mbahen takime fizike prej 8 vetash dhe ato virtuale (pasi ka mjete audio-vizuale)
 - EDUCO Hapësira ka për qëllim të shërbejë si hapësirë me qëllime të shumta duke filluar nga sallë trajnimesh, sallë diskutimesh, co-working space dhe salle rekrijimi.
 - EDUCO Podcast është hapësirë mediale në vete
- Në këto hapësira bëhet përcaktimi i prioritetëve dhe i angazhimeve, përpilohen listat e detyrave të cilat përfshijnë ato kyçe dhe përcjellëse, ku përcaktohen se cilat detyra janë më të rëndësishme dhe duhet të kryhen më parë.
- Puna në zyre do të bëhet gjithmonë me përdorimin e një sistemi të menaxhimit të kohës për të rritur efikasitetin. Përdorimi i një liste detyrash, kalendare dhe teknika

të tjera për të mbajtur nën kontroll kohën dhe për të përmbushur detyrat në afatet e duhura.

- Tënderinca të vazhdueshme për komunikim efektiv do të jetë pikë e rëndësishme tek puna në zyrë. Sigurimi që komunikimi të jetë i qartë dhe efektiv brenda organizatës, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi për të siguruar që i gjithë ekipi punues të jetë në dijeni të detyrave dhe përgjegjësi të tyre.
 - Krijimi i një mjedisi të qasshëm të punës në zyrë që është i rehatshëm dhe i përkrahur për punën dhe produktivitetin ka një rol kyç. Do të përfshihen zona të qeta pune (mund të jetë EDUCO Hapësira një opcion), mundësi për pushime dhe resurse të tjera për të ndihmuar ekipin punues të jenë të fokusuar dhe të motivuar.
 - Në zyrë por edhe në ambiente të tjera do të ketë monitorim dhe vlerësim. Vendosja e një sistemi për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e personave të involvuar në aktivitete do të risë kualitetin e aktiviteteve dhe parandalon situata të paparashikuara që mund të ndikojnë negativisht në mbarëvajtjen e aktiviteteve. Kjo përfshin mbledhjen e feedback-ut, vlerësimin e rezultateve dhe ofrimin e mundësive për zhvillim.
 - Për fleksibilitet të punës në zyrë do të ofrohet një gradë e caktuar të fleksibilitetit në orarin e punës dhe organizimin e detyrave për të lehtësuar balancën midis punës dhe jetës personale.
- **Puna në terren:** puna në terren sjell një dimension më të afërt me komunitetet dhe nevojat e tyre. Ekipi në terren ndihmon në implementimin e projekteve, ndërliiden me qytetarët dhe sigurojnë që aktivitetet të përshtaten me realitetin lokal. Kombinimi i punës në zyrë dhe në terren siguron një koordinim të përsosur, duke mundësuar një ndërveprim efektiv midis strategjive të planifikuara dhe sfidave konkrete. Kjo pjesë e dyfishtë e punës ndihmon në sigurimin e një ndikimi pozitiv dhe të qëndrueshëm në shoqëri. Hapat thelbësorë të punës në terren do të jenë:
 - Analizimi i nevojave dhe kontekstit: Fillohet duke kuptuar nevojat e komunitetit dhe kontekstin në të cilin punohet në terren. Identifikohen problemet kryesore dhe sfidat që duhet të adresohen dhe përshtaten planifikimet e punës në bazë të tyre.

- Planifikimi i punës: Përcaktimi i qëllimeve specifike të projektit në terren dhe hartimi i një plan veprimi të qartë për të arritur ato qëllime. Identifikimi i detyrave specifike dhe resurset që do të nevojiten për t'i realizuar ato.
 - Krijimi i ekipit të punës: Formimi i një ekipi të përshtatshëm për projektin në terren, duke përzgjedhur individ me aftësi dhe përvojë të përshtatshme për detyrat specifike. Sigurimi që të gjithë anëtarët e ekipit të kenë njohuri të mira për kontekstin lokal dhe kulturën e zonës.
 - Koordinimi dhe komunikimi: Sigurimi që komunikimi të jetë i qartë dhe efektiv brenda ekipit dhe me palët e interesuara lokale. Përdorimi i teknologjive dhe kanaleve të komunikimit të përshtatshme për situatën në terren.
 - Monitorimi dhe vlerësimi i progresit: Vendosja e një sistemi për të monitoruar progresin e projektit dhe për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve në terren. Përdorimi i indikatorëve të qartë për të vlerësuar rezultatet dhe për të identifikuar ndryshimet e nevojshme në planin e punës.
 - Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria: Në një mjedis të ndryshueshëm si terreni, është e rëndësishme që të bëhet përshtatja me ndryshimet e paparashikuara dhe të merren masa të menjëhershme për të adresuar sfidat e reja.
 - Bashkëpunimi me komunitete: Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me komunitetin lokal dhe përfshirja e tyre në procesin e planifikimit dhe zbatimit të projektit. Sigurimi që puna të jetë në përputhje me nevojat dhe interesat e komunitetit.
- **Puna në punëtoritë:** Workshopet janë një mjet efektiv për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive, duke ofruar platforma për ndarjen e njohurive, aftësive dhe përvojave. Puna me workshope do të bëhet për të trajtuar çështje të ndryshme si edukimi, zhvillimi i aftësive dhe trajnimi i individëve në programet e EDUCO. Këto aktivitete ofrojnë një hapësirë për diskutim dhe shkëmbim idejash midis individëve dhe grupeve, duke ndihmuar në identifikimin e sfidave dhe gjetjen e zgjidhjeve inovative. Organizimi i punëtorive si një mjet efektiv për të kultivuar një kulturë të përgjegjshme dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të fuqishme dhe më të informuar, do të bëhet duke bërë:
 - Definimi i qëllimeve dhe temave të punëtorive: Përcaktohen qëllimet e punëtorive dhe temave të diskutimit. Sigurohet që qëllimet të jenë të qarta dhe të përshtatshme

për audiencën dhe që tema të jetë e rëndësishme dhe e interesueshme për pjesëmarrësit.

- Zgjedhja e pjesëmarrësve: Identifikimi i audiencës për punëtori dhe sigurimi që pjesëmarrësit të jenë të përshtatshëm për temat dhe qëllimet e diskutimit. Duke bërë thirrje të hapur për pjesëmarrësit dhe duke përdorur një proces të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në bazë të kriterëve të caktuar.
 - Hartimi i agjendës dhe strukturës së punëtorisë: Përgatitja e një agjendë të qartë dhe të strukturuar për punëtori, duke përfshirë sesione të ndryshme dhe aktivitete të përshtatshme për të arritur qëllimet e caktuara. Sigurimi që të ketë kohë për prezantime, diskutime, aktivitete grupore, dhe sesione reflektimi.
 - Përgatitja e materialeve dhe resurseve: Përgatitja për punëtori duke përgatitur materiale të nevojshme si prezantime, shënime, materiale të leximit. Sigurimi të ketë resurse teknike dhe logjistike të nevojshme për të mbajtur punëtorinë me sukses.
 - Fasilitimi i punëtorisë: Kur mbahet punëtorinë, sigurimi që të ndjeket agjenda dhe struktura e hartuar më parë. Fasilitohen diskutimet dhe aktivitetet në mënyrë që të sigurohen kontributet e të gjithë pjesëmarrësve dhe që të arrihen qëllimet e caktuara.
 - Monitorimi dhe vlerësimi i performancës: Pas përfundimit të punëtorisë, bëhet një vlerësim i performancës duke marrë feedback nga pjesëmarrësit dhe duke vlerësuar nëse qëllimet e caktuara janë arritur. Identifikimi se çfarë ka funksionuar mirë dhe çfarë mund të përmirësohet për punëtorinë e ardhshme.
 - Veprimet pas punëtorisë: Veprime për të ndjekur rezultatet dhe për të ndarë informacionin e rëndësishëm me pjesëmarrësit. Duke përdorur email, materiale të shkruara ose aktivitete të tjera për të vazhduar dialogun dhe veprimtarinë e inicjuar nga punëtorinë.
- **Puna në aktivitete:** Është një proces i përkushtuar dhe ndërgjegjësor që synon të arrijë qëllimet dhe objektivat e organizatës në një mënyrë të ndikshme dhe efektive. Kjo përfshin organizimin, koordinimin, dhe zbatimin e projekteve, eventeve dhe programesh që janë në përputhje me misionin dhe vizionin e OJQ-së. Pjesa e punës në aktivitete lidhet ngushtë

me përgatitjen e planifikimeve strategjike, hartimin e buxhetit, dhe identifikimin e resurseve të nevojshme për realizimin e secilit aktivitet.

Puna në aktivitete është një pjesë e rëndësishme e përmbushjes së misionit dhe ka një ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara. Kjo përfshin një gamë të gjërë të detyrave dhe përgjegjësi që shpesh kërkojnë fleksibilitet, kreativitet dhe përkushtim për të kontribuar në ndryshimin pozitiv të shoqërisë duke filluar me:

- Identifikimin e qëllimeve të aktivitetit: Përfshirë të kuptuarit e arsyes për zhvillimin e aktivitetit, çfarë synohet të arrihet përcaktohen qëllimet e qarta për aktivitetin.
- Përcaktimin e audiencës dhe pjesëmarrësve: Sigurimi që të caktohet një audiencë e përshtatshme për qëllimet dhe mesazhet e aktivitetit, identifikimi i audiencës dhe pjesëmarrësve potencial të aktivitetit është kyçe.
- Planifikimin e strukturës dhe formatit: Hartimi i një plani të detajuar për strukturën dhe formatin e aktivitetit që përfshin zgjedhjen e llojit të aktivitetit (punëtori, ngjarje, fushatë, etj.), si dhe planifikimin e sesioneve, prezantimeve, dhe aktiviteteve të tjera.
- Përgatitjen e materialeve dhe resurseve: Përgatitja për aktivitetin duke zhvilluar materiale të nevojshme si prezantime, materiale promovuese dhe materiale të tjera për pjesëmarrësit. Pra, është shumë e rëndësishme sigurimi i resurseve teknike dhe logjistike të nevojshme për të realizuar aktivitetin me sukses.
- Krijimin e planit të promovimit: Hartimi i planit të promovimit për të njoftuar audiencën dhe për të tërhequr pjesëmarrësit për aktivitetin duke përdorur kanale të ndryshme të komunikimit si rrjetet sociale, email, faqet e internetit dhe fletushka digjitale.
- Fasilitimin e aktiviteteve: Ndjekja e planit dhe prania e një ekipi të përshtatshëm për të menaxhuar detajet operative është bazike për fasilitimin e sesioneve dhe aktiviteteve në mënyrë që të sigurohet angazhimi dhe pjesëmarrja aktive e pjesëmarrësve.
- Monitorimin dhe vlerësimin e performancës: Pas përfundimit të aktivitetit, bëhet një vlerësim i performancës duke përdorur feedback nga pjesëmarrësit dhe duke vlerësuar nëse qëllimet e caktuara janë arritur. Identifikimi se çfarë ka funksionuar mirë dhe çfarë mund të përmirësohet për aktivitetet e ardhshme.

- Pas-aktivitetit: Përfshirja e pas-aktivitetit për të ndjekur rezultatet dhe për të ndarë informacionin e rëndësishëm me pjesëmarrësit, ku mund të përdoren email, materialet e shkruara ose aktivitete të tjera për të vazhduar dialogun dhe veprimtarinë e iniciuar nga aktiviteti.

6. Fushëveprimet

6.1 Edukim/Trajnim

Fusha e veprimtarisë së OJQ EDUCO përfshin ndërmarrjen e aktiviteteve të ndryshme që synojnë të mbështesin edukimin, trajnimin, si dhe në ndihmesë për zhvillim të kapaciteteve personale dhe profesionale për individë dhe komunitete. Target grup i këtij fushëveprimi do të jenë në veçanti të rinjtë, por duke mos anashkaluar të gjitha grup moshat ai në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale. Këto aktivitete përfshijnë:

- Trajnimet përmes edukimit jo-formal;
- Organizimi i kurseve dhe trajnimeve për ngritje të kapaciteteve personale dhe profesionale;
- Mbështetjen e të rinjëve përmes trajnimeve për qasje në tregun e punës;
- Trajnimet për ndërmarrësi, ndërmarrësi sociale dhe aftësi të buta;
- Zhvillimi i programeve të edukimit për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi çështjet e edukimit dhe arsimit;
- Ndërmarrja e aktiviteteve të tjera që synojnë të mbështesin edukimin dhe arsimimin në mënyra të tjera.

6.2 Përfshirje Sociale

EDUCO synon të luaj një rol të rëndësishëm në përfshirjen sociale duke punuar me grupet e marginalizuara, me komunitetet dhe gjithë grupet sociale për ndërtimin e mirëkuptimit, respektit dhe barazisë, duke:

- Organizuar seminare dhe punëtori për t'u angazhuar dhe dëgjuar shqetësimet e grupeve të marginalizuara, komuniteteve dhe të gjith grupeve sociale;
- Bashkëpunimi me drejtuesit lokalë dhe vendimmarrësit për të rritur të kuptuarit e nevojave të komuniteteve të ndryshme;

- Avokimi për politika dhe praktika që përfshijnë të gjithë anëtarët e shoqërisë;
- Lehtësimi i dialogut ndërmjet anëtarëve të grupeve të ndryshme për të ndërtuar mirëkuptim dhe marrëdhënie sa më të shëndetshme dhe diplomatike.

Aktivitetet sociale ndihmojnë në promovimin e përfshirjes duke i bashkuar njerëzit dhe duke i ndihmuar ata të kuptojnë njëri-tjetrin, të ndërtojnë mirëkuptim dhe pranim të grupeve të ndryshme dhe gjithashtu puna së bashku në projekte ose kauza do të jetë një mënyrë e fuqishme për të promovuar përfshirjen.

6.3 Trashëgimi Kulturor

Qëllimi i fushës së veprimtarisë së OJQ-së EDUCO për trashëgiminë kulturore duhet të jetë për mbështjen, ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Kjo mund të përfshijë ndërmarrjen e aktiviteteve të ndryshme që synojnë të mbështesin ruajtjen dhe promovimin e elementeve të trashëgimisë kulturore si dhe të ndihmojnë në zhvillimin e një qytetarie të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme mbi trashëgiminë e tyre kulturore. Target grup i këtij fushëveprimi do të jenë në veçanti të rinjtë, por duke mos anashkaluar të gjitha grup moshat në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale.

Aktivitetet që do të përfshij fusha e veprimtarisë së OJQ-së EDUCO për trashëgimin kulturore janë:

- Organizimi i ekspozitave dhe eventeve që synojnë të promovojnë trashëgiminë kulturore të një vendi ose komuniteti;
- Organizimi i kurseve dhe trajnimeve për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi trashëgiminë kulturore;
- Mbështetje për të përmirësuar qasjen në mësimin e trashëgimisë kulturore për të gjithë qytetarët, veçanërisht për ata që janë të pambrojtur ose të ndërlikuar në mënyra të ndryshme;
- Ndërmarrja e aktiviteteve të tjera që synojnë të mbështesin ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të një vendi ose komuniteti në mënyra të tjera.

6.4 Kulturë

Në kulturë dhe art, OJQ EDUCO do të përfshihet në një gamë të gjerë aktivitetesh. Këto aktivitete do të ndahen në tre kategori: edukimi i artit dhe kulturës, promovimi i arteve dhe kulturës dhe të drejtat e artit dhe kulturës. Target grup i këtij fushëveprimi do të jenë në veçanti të rinjtë, por duke mos anashkaluar të gjitha grup moshat në zonat urbane po ashtu edhe në ato rurale.

- Edukimi i artit dhe kulturës i referohet nismave të ndërmarra nga OJQ-ja për të edukuar publikun rreth artit dhe kulturës. Kjo mund të përfshijë organizimin dhe drejtimin e punëtorive, krijimin e materialeve edukative dhe organizimin e ngjarjeve të ndryshme kulturore;
- Promovimi i artit dhe kulturës i referohet aktiviteteve të ndërmarra nga OJQ EDUCO për të promovuar artin dhe kulturën. Kjo do të përfshijë mbështetjen e artistëve dhe organizatave kulturore, organizimin e ngjarjeve dhe festivaleve, dhe avokimin për art;
- Të drejtat e artit dhe kulturës i referohen përpjekjeve të OJQ-së për të justifikuar dhe mbrojtur të drejtat e artistëve dhe punonjësve të kulturës. Kjo mund të përfshijë fushatën për kushte më të mira pune, luftën për të drejtat e autorit të artistit, dhe çdolloj mbështetje për komunitetin artistik që kanë synim përmirësimin dhe zhvillimin e shoqërisë përmes kulturës dhe artit.

Të gjitha këto aktivitete janë të rëndësishme për promovimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë. Këto aktivitete të OJQ EDUCO do të ndihmojnë për të rritur ndërgjegjësimin për padrejtësitë, për të edukuar njerëzit për të drejtat e tyre dhe për të fuqizuar grupet e marginalizuara përmes artit dhe kulturës.

6.5 Rini

Ofrimi i burimeve dhe mbështetjes arsimore, organizimin e seminareve dhe punëtorive të fokusuara tek të rinjtë.

- Ofrimi i programeve të mentorimit dhe stërvitjes;
- Aktivitete të ndryshme edukative që i ndihmojnë të rinjtë të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë që u nevojiten për të pasur sukses në jetë, duke fituar gjithashtu një kuptim më të madh të çështjeve që prekin komunitetin e tyre;
- Fuqizimi i të rinjve në politika të vendimmarrjes dhe avokimit për të drejta të barabarta dhe gjithpërfshirje, duke ndërtuar lider të së ardhmes.

7. Programet

Në OJQ EDUCO gjatë periudhës 2024 - 2028 planifikohet të jenë këto programe vjetore:

1. Konferenca e Turizmit dhe Mikpritjes në Prizren - KonTur
2. Edukimi dhe Trajnimi
3. Media
4. Trashëgimia Kulturore
5. Erasmus +

Afati i programeve do të ndahet në:

- Afat shkurtë - 0-1 vjet
- Afat mesëm - 1-2 vjet
- Afat gjatë - 2-4 vjet

7.1 Konferenca e Turizmit dhe Mikpritjes në Prizren - KonTur

Konferenca e cila planifikohet të mbahet çdo vjet, do të mbulojë një sërë temash që lidhen me industrinë e turizmit dhe do të shërbejë si një platformë për ekspertët, praktikuesit dhe palët e interesuara për të shkëmbyer njohuri, ide dhe bashkëpunime në mënyra të ndryshme për të përmirësuar industrinë e turizmit.

Organizimi i konferencës vjetore do të ndihmojë në promovimin e destinacioneve turistike në nivel lokal dhe ndërkombëtar duke rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e njerëzve për të vizituar vendin. Do të ndikojë në rritjen e të ardhurave në industrinë e turizmit në vend duke përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet për turistët dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për ta. Gjithashtu, do të ndikojë në zhvillimin e fushës së turizmit duke krijuar mundësi të reja biznesi dhe duke rritur punësimin në sektorin e turizmit.

K o n	Synimi: Konferenca Turistike e organizuar çdo vjet				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	KonTur 2024	I lartë	Shkurtë	Kërkim për sponzor

T u r	2	KonTur 2025	I lartë	Mesëm	Kërkim për sponzor
	3	KonTur 2026	I lartë	Gjatë	Gjenerimi i të ardhurave përmes pagesave për pjesëmarrje
	4	KonTur 2027	I lartë	Gjatë	Gjenerimi i të ardhurave përmes pagesave për pjesëmarrje
	5	KonTur 2028	I lartë	Gjatë	Gjenerimi i të ardhurave përmes pagesave për pjesëmarrje

7.2 Edukim dhe Trajnim

Programi i edukimit dhe trajnimit është një iniciativë e përkushtuar për të ofruar mundësi të arritjes së njohurive dhe zhvillimit të aftësive për të gjithë pjesëmarrësit. Duke u bazuar në vlerat e përmirësimit të arsimit dhe promovimit të zhvillimit personal dhe profesional, ne ofrojmë një gamë të gjerë të programeve të përshtatura për nevojat e ndryshme të komunitetit tonë.

Përmes kurseve të specializuara, trajnimeve praktike dhe aktiviteteve inovative, synojmë të ndihmojmë mësimdhënësit, nxënësit dhe të gjithë të rinjtë dhe të rejtat që janë të përfshirë në procesin e mësimin për të arritur sukses në karrierën e tyre dhe për të bërë ndikim pozitiv në shoqërinë tonë. Nëpërmjet një angazhimi të vazhdueshëm për cilësi të lartë dhe inovacion në arsim, ne shpresojmë të ndërtojmë një mjedis të frytshëm për rritjen dhe zhvillimin e njohurive dhe aftësive në të gjithë komunitetin.

E d	Synimi: Edukimi i mirëfilltë				
	Objektivi 1: Promovimi i metodave të reja mësimore				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti

u k i m d h e T r a j n i m	1	Punëtori inovative për 20 mësimdhënës: Për të zhvilluar aftësi dhe strategji inovative për të përdorur teknologjinë dhe metodat e reja mësimore në klasë.	I mesëm	Mesëm	Sipas projekteve; në shkolla urbane dhe rurale. Synohet trajnimi i 20 mësimdhënësve.
	2	Punëtori inovative për 30 të rinjë dhe të reja	I lartë	Gjatë	Sipas projekteve; në vende urbane dhe rurale
	3	Organizimi i trajnimeve në 5 fshatra	I mesëm	Mesëm	Trajnim me tema: Aftësi të buta, ndërrmarësi, media sociale, etj.
	4	Sesione informuese për tema të cilat do të përzgjidhen sipas projekteve aktuale	I mesëm	Gjatë	
	5	Hulumtime dhe Publikime për tema të caktuara	I lartë	Gjatë	Sipas Projekteve. Synohet të ketë të paktën 2 publikime brenda vitit.

E d u k	Synimi: Edukimi i mirëfilltë				
	Objektivi 2: Ngritja e kapaciteteve e të rinjëve				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti

i m d h e T r a j n i m	1	Trajnime në Programe të ndryshme kompjuterike: QGIS - 20 të rinj përgjatë 2024/28 ISOFT - 20 të rinj përgjatë 2024/28 Programet e Adobe - 20 të rinj përgjatë 2024/28 Programet e CAD - 20 të rinj përgjatë 2024/28	I mesëm	Gjatë	Trajnimet do të ofron në periudha të ndryshme kohore sipas nevojës.
	2	Trajnim për aftësi të buta për 30 të rinjë përgjatë 2024/28 në: komunikimi prezentimi shkrimi i CV dhe letrës motivuese shkrimi i E-mail menaxhimi i kohës pune ekipore vendimmarrja	I mesëm	Gjatë	Trajnimet do të organizohen në hapësirat e EDUCO, shkolla të ndryshme si në vende urbane po ashtu edhe ne rurale si dhe në hapësira tjera të nevojshme.
	3	Trajnim për Lidërsip për 30 të rinjë	I ultë	Gjatë	
	4	Aftësitë e përparimit teknologjik: Trajnimi për të mësuar teknika dhe mjete të reja teknologjike, duke përfshirë programet e softuerit, platformat në linjë, dhe teknologjitë e avancuara për të përmirësuar efikasitetin në vendin e punës.	I ultë	Gjatë	
	5	Aftësitë e zhvillimit të karrierës: Trajnimi për të zhvilluar njohuri dhe aftësi për planifikimin	I ultë	Gjatë	

		e karrierës, identifikimin e synimeve dhe mundësive dhe për të menaxhuar zhvillimin dhe avancimin në karrierë.			
--	--	--	--	--	--

7.3 Media

Programi i medias në OJQ EDUCO është një iniciativë e përkushtuar për të promovuar shkëmbimin e informacionit dhe ndërgjegjësimin në komunitet. Përmes një game të gjerë aktiviteteve, përfshirë produksionin mediatik, organizimin e punëtorive, trajnimeve dhe ngjarjeve, programi synon të ndihmojë në zhvillimin e një kulture mediatike të qytetarëve aktive dhe të informuar. Synimi është promovimi i të rinjve në fusha, drejtime dhe profesione të ndryshme, veçanërisht të rinjtë e talentuar nga Komuna e Prizrenit dhe rrethina. Bisedime me akterë të ndryshëm që mund të kontribuojnë në edukimin e të rinjve në audiencën tonë dhe jo vetëm. Përmes këtij programi, OJQ EDUCO synon të kontribuojë në rritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe në përmirësimin e debatit publik.

Media	Synimi: Ngritja e audiencës në EDUCO Podcast				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Realizimi i 4 sezonave	I lartë	Gjatë	
	2	Realizimi i 24 episodave në çdo vit	I lartë	Gjatë	
	3	Realizimi i episodave jashtë programit	I ultë	Gjatë	Në rast të ndonjë shënimi të ditëve ndërkombëtare, sipas projekteve dhe ngjarjeve të ndryshme

	4	Shfaqja e EDUCO Podcast në ndonjë Televizion Lokal	I ultë	Gjatë	
	5	Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me organizata të tjera, institucione arsimore, dhe komunitete lokale për të promovuar podcastin në një spektrum më të gjerë audiencash.	I mesëm	Gjatë	

M e d i a	Synimi: Realizimi i EDUCO Videos				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Realizimi i videos për 17 Shkurt - Dita e Pavarësisë së Kosovës	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me Grupin Jo-Formal të Organizatave Jo-Qeveritare
	2	Realizimi i videos për 20 Mars - Dita Ndërkombëtare e Lumturisë	I lartë	Gjatë	
	3	Realizimi i videos për 22 Prill - Dita e Tokës	I lartë	Gjatë	Rëndësia e Efiqencës dhe Miqësisë me natyrën
	4	Realizimi i videos për 18 May - Dita Ndërkombëtare e Muzeve	I lartë	Gjatë	
	5	Realizimi i videos për 1 Qershor - Dita e fëmijeve	I lartë	Gjatë	

6	Realizimi i videos për 3 Qershor - Dita Bicikletave	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me Marakli të Bicikletave
7	Realizimi i videos për 5 Qershor - Dita e Ambientit	I lartë	Gjatë	
8	Realizimi i videos për 21 Qershor - Dita Nderkombetare e Yoga	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me Sporting
9	Realizimi i videos për 30 Qershor - Dita Ndërkombëtare e Asteroideve	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me OJQ CET
10	Realizimi i videove të ndryshme të cilat mund të dalin nga projektet	I lartë	Gjatë	

M e d i a	Synimi: Realizimi i Shiko Nga Lartë				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Realizimi i vazhdimet të videove në Komunën e Prizrenit	I lartë	Shkurtë	
	2	Realizimi i videove në Rajonin e Prizrenit	I mesëm	Mesëm	
	3	Realizimi i videove në Kosovë	I ulët	Gjatë	
	4	Përditësimin e Platformës: https://shikongalarte.com/	I mesëm	Gjatë	

	5	Promovimin e Platfomës në shkolla në vendet urbane dhe rurale	I mesëm	Gjatë	
--	---	---	---------	-------	--

7.4 Trashëgimia Kulturore

Programi për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë synon të promovojë, të mbrojë dhe të promovojë trashëgiminë kulturore të vendit në mënyrë të qëndrueshme dhe inovative. Përmes një game të gjerë aktivitetesh, përfshirë hulumtime të terrenit, dokumentime, promovim në media, punë në komunitet dhe edukim, ky program synon të rikthejë vëmendjen ndaj pasurive kulturore të Kosovës dhe të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe vlerësimit të tyre nga komuniteti vendor dhe ndërkombëtar. Nëpërmjet përpjekjeve të këtij programi, synohet të kujdeset për trashëgiminë kulturore si një burim i pasur i identitetit dhe të krijojë një mjedis të përbashkët për përkrahjen dhe mbështetjen e praktikave dhe projekteve që kontribuojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës për brezat e ardhshëm.

T r a s h ë g i m i a K u	Synimi: Promovimi i Trashëgimisë Kulturore				
	Objektivi 1: Ruajtja dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Digjitalizimi i Trashëgimisë Kulturore: Përdorimi i teknologjisë për të dokumentuar dhe ruajtur trashëgiminë kulturore në një format të digitalizuar, duke përdorur fotografi 360°, modelime 3D, dhe baza të të dhënave online për të lehtësuar qasjen dhe studimin e saj.	I ultë	Gjatë	
	2	Realizimi i videove Dokumentare me intervista për banorët të cilët jetojnë në	I ultë	Gjatë	

I t u r o r e		Monumentet e Trashëgimisë Kulturore - Shtëpi tradicionale.			
--	--	--	--	--	--

T r a s h ë g i m i a K u l t u r o r e	Synimi: Promovimi i Trashëgimisë Kulturore				
	Objektivi 2: Sensibilizimi, trajnimi dhe edukimi i publikut				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Sensibilizimi i Publikut: Organizimi i aktiviteteve edukative dhe informuese për të rritur ndërgjegjësimin rreth rëndësisë së trashëgimisë kulturore dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive në ruajtjen e saj. Këto aktivitete mund të përfshijnë udhëtime të guiduara, seminare, ekspozita, etj.	I lartë	Gjatë	
	2	Konferenca e Qendrës Historike të Prizrenit - 2024	I lartë	Shkurtë	Në bashkëpunim me QRTK - Prizren
	3	Punëtori për vetëdijësimin e mbrojtjes të Trashëgimisë Kulturore	I mesëm	Gjatë	
	4	Udhërrëfime në vendet historike dhe kulturore në rajonin e Prizrenit	I ultë	Gjatë	

	5	Krijimin e materialeve edukative për shkollat dhe grupet e interesit të ndryshëm	I ultë	Gjatë	
--	---	--	--------	-------	--

T r a s h ë g i m i a K u l t u r o r e	Synimi: Promovimi i Trashëgimisë Kulturore				
	Objektivi 3: Restaurimi i artefakteve/monumenteve të Trashëgimisë Kulturore				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Punëtorja: Restaurimi i artefakteve arkeologjike në Muzeun Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit - Sahat Kulla	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me QRTK - Prizren
	2	Punëtorja: Restaurimi i artefakteve etnologjike në Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit	I lartë	Gjatë	Në bashkëpunim me QRTK - Prizren
	3	Restaurimi dhe Konservimi: Kujdesi dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore për të siguruar që ato të mbeten të qëndrueshme dhe të qëndrojnë si burime të vlefshme historike dhe kulturore. Kjo përfshin punë në objekte arkitekturore, artefakte, monumente, etj.	I mesëm	Gjatë	Në bashkëpunim me QRTK - Prizren dhe institucione tjera

7.5 Erasmus +

Nëpërmjet programit Erasmus+, organizata mund të organizojnë shkëmbime të qëndrueshme të studentëve dhe stafit, duke integruar sfidat e bashkëkohësisë në fusha të ndryshme të dijes dhe praktikave të përmirësimit. Nëpërmjet partneriteteve ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta, kjo eksperiencë rinore dhe kulturore kontribuon në zhvillimin e një mjedisi më të hapur, më të diversifikuar dhe më të afruar ndërkombëtarisht për të gjithë pjesëmarrësit.

Erasmus +	Synimi: Partneritet me organizata ndërkombëtare				
		Aktiviteti	Prioriteti	Afat	Komenti
	1	Partneritet me organizata ndërkombëtare	I lartë	Gjatë	Dy partneritete çdo vit.
	2	Shkëmbime rinore në shtete të ndryshme për tema të caktuara sipas projektit	I mesëm	Gjatë	
	3	Trajnime të ndryshme me të rinjtë e Prizrenit në shtetet të cilat përcaktohen sipas projektit	I mesëm	Gjatë	
	4	Punëtori lokale nga projektet	I mesëm	Gjatë	Pas krijimit të partneriteteve me organizatat ndërkombëtare
	5	Aplikim për projekt të Erasmus+	I lartë	Gjatë	Duke filluar nga viti 2025

8. Shënimi i ditëve Ndërkombëtare

Në kalendarin e vitit, ka një sërë ditësh ndërkombëtare që shënojnë ngjarje, vlera, dhe sfida globale. Këto ditë janë shenime të rëndësishme që nxisin ndërgjegjësimin e njerëzve për çështje të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit. Ato janë shenja të bashkëpunimit dhe respektit për diversitetin kulturor. Nëpërmjet këtyre ditëve ndërkombëtare, njerëzit bëjnë përpjekje për të shpërndarë mesazhe të rëndësishme, të ngrihen në solidaritet, dhe të promovojnë ndryshime pozitive në botë.

Nr.	Shënimi i ditëve ndërkombëtare
1	24 Janar - Dita Ndërkombetare e Edukimit
2	17 Shkurti - Dita e Pavaresisë së Kosovës
3	20 Mars - Dita Ndërkombëtare e Lumturisë
4	21 Prill - Dita Kreativitetit dhe Inovacionit
5	22 Prill - Dita e Tokës
6	18 Maj - Dita Ndërkombëtare e Muzeve
7	1 Qershori - Dita e Fëmijeve
8	3 Qershori - Dita Bicikletave
9	5 Qershori - Dita e Ambientit
10	21 Qershori - Dita Ndërkombetare e Yoga
11	30 Qershori - Dita Ndërkombëtare e Asteroideve
12	12 Gusht - Dita e të Rinjëve
13	3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit

Strategjia e organizatës për vitin 2024-2028 u miratua në takimin e Kuvendit të Anëtarëve të organizatës EDUCO, mbajtur më 29 Qershor 2024, në Prizren.

Në emër të organizatës EDUCO

Enis Shkurti, drejtor ekzekutiv

Edukimi për Zhvillim dhe Shërbime Kulturale /
Education for Development and Cultural Outreach

EDUCO